



K.DH.SH.II.nr.861/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kabashi Group” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të ushtruar kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.153/22 të datës 23.01.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.153/22 i datës 23.01.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.153/22 të datës 23.01.2023, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Kabashi Group” Sh.p.k. II. Anulohen Vendimi nr. prot. 566/2018 i datës 21.12.2018 dhe Vendimi për shqiptimin e masës ndëshkimore nr. 01 Nr. 40-131/2018 C i datës 06.11.2018, të nxjerra nga i padituri Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës. III. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesja e të paditurës, Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet ankesa e paditurës, të prishet Aktgjykimi KA.nr.153/22 i datës 23.01.2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Administrative dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës – Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës me nr.protk.566/2018 i datës 21.12.2018 dhe Vendimi për shqiptimin e masës ndëshkimore 01Nr.40-131/2018C i datës 06.11.2018.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 49 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi “Kabashi Group” ShPK me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi në gjykatë duke iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, (MPMS) respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.566/2018 dt.21.12.2018 dhe vendimin 01Nr.40-131/2018C i datës 06.11.2018 i të paditurës Inspektoratit të Punës, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Dhoma e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 16.01.2023, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimet kontestuese të paditurës, raporti zyrtar i inspektoratit të punës, si dhe shkresat tjera, ligjet në fuqi, andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë Dhoma e shkallës së parë, vendosi që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar është theksuar se Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për çfarë ka sjellë në zbatim të gabuar të së drejtë materiale, përkatësisht dhe nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 8 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë që përcakton se “4. Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë.” dhe par. 5 i cili përcakton se: “Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin.” Gjykata nga provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar, ka konstatuar se investitori ka lidhur marrëveshje kontraktuale me punë kryesin në kuptim të nenit 8 par. 4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, me të cilën marrëveshje në nenin 12 ka bartuar në tërësi përgjegjësinë tek punë kryesi e po ashtu edhe me Aneks Marrëveshjen ka përcaktuar të gjitha përgjegjësitë për sigurinë në punë tek punë kryesi. Pra në këtë rast nuk mund të aplikohet par. 5 i nenit 8 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë që lë përgjegjësinë tek investitori në rastet kur nuk arrihet marrëveshje pasi që edhe i padituri në procedurë administrative ka pasur në posedim kontratën dhe aneks kontratën me të cilat e gjithë përgjegjësia ka qenë e bartur tek punë kryesi. Gjykata po ashtu vlerësoi edhe shkeljet e pretenduara nga i padituri, përkatësisht nenin 5 par.1 dhe nenin 6 par.1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por konstatoi se këto shkelje janë të përcaktuara për punëdhënësin që të sigurojë kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës, ndërsa nga arsyetimi i Vendimit 01nr.40-132/2018C, gjykata konstatoi se gjatë inspektimit të datës

02.11.2018 punë kryesit i janë gjetur 5 të punësuar duke punuar pa pajisjet mbrojtje në punë, pra të punësuar nga punë kryesi N.N.Sh. “Nasa”, ashtu që edhe dispozitat e lartcekura kanë obliguar në këtë rast punë kryesin si punëdhënës. Lidhur me pikën III të gjobës nga vendimi kontestues, gjykata ju referua nenit 23 par. 1, 2, 3 dhe 4 i cili përcakton se: “1. Në rastet kur ka ndodhur aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës. 2. Për aksidentet në punë, inspektori i punës detyrohet të bëjë procesverbal me shkrim me të cilin konstaton gjendjen faktike në kohën kur ka ndodhur aksidenti. 3. Inspektori i punës do t’i marrë masat adekuate në pajtim me ligjin për shkeljet e konstatuara në rastin kur ka ndodhur aksidenti. 4. Inspektori i punës urdhëron me vendim ndërrmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e rrezikut, dhe nëse ka fakte të pamohueshme se kushtet e punës paraqesin rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve, urdhëron ndalimin e përkohshëm të procesit të punës në atë subjekt punues, njësi të subjektit punues ose makinë punuese ...” Ndërlidhur me këtë dispozitë dhe provat e administruara në këtë çështje, gjykata konstaton se i padituri gabimisht ka konstatuar se paditësi nuk ka zbatuar nenit 23 par.4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë pasi që siç është përcaktuar në titull të nenit 23 por edhe në tërësinë e përmbajtjes së këtij nenit, rregullohet procedura e njoftimit lidhur me aksidentet në punë, andaj nuk mund të bëhet interpretimi vetëm i paragrafit 4 të këtij neni në shkëputje nga paragrafët tjerë të këtij neni. Andaj, duke qenë se në asnjërin nga raportet e administruara si prova nuk është konstatuar se ka pasur aksident në punë, paditësi nuk mund të ngarkohet me asnjë shkelje nga neni 23 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale, këtë qëndrim juridik të Dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e nenit 8 paragrafi 4 dhe nenin 23 par.1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktgjyqimit të ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me shkeljet ligjore që ka zbatuar e paditura me rastin e vendimmarrjes në procedurën administrative kur paditësit i ka shqiptuar masa ndëshkimore konform nenit 5 paragrafi 1, nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 4 të Ligjit nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Kolegji pranon qëndrimin juridike të gjykatës e shkallës së parë me të cilën ka konstatuar se i padituri gabimisht ka konstatuar se paditësi nuk ka zbatuar nenit 23 par.4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë pasi që, siç është përcaktuar në titull të nenit 23 por edhe në tërësinë e përmbajtjes së këtij nenit, rregullohet procedura e njoftimit lidhur me aksidentet në punë, andaj nuk mund të bëhet interpretimi vetëm i paragrafit 4 të këtij neni në shkëputje nga paragrafët tjerë të këtij neni. Andaj, duke qenë se në asnjërin nga raportet e administruara si prova nuk është konstatuar se ka pasur aksident në punë, paditësi nuk mund të ngarkohet me asnjë shkelje nga neni 23 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Dhoma e shkallës së parë ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike për faktin se gjatë shqyrtimit të çështjes nuk i mori parasysh faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në ligj, sepse Dhoma e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të bazuara, dhe në anën tjetër e përfaqësuesja e paditurës në ankesë dhe as në procedurën e konfliktit administrativ, nuk ka ofruar para gjykatës dëshmi për të vërtetuar të kundërtën e asaj që është theksuar në aktgjykimin e kontestuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet ankimore janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk cenar ligji në dëm të paditurës, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjeti se Dhoma e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.861/23 datë 22.02.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi